

FJALA E DEPUTETES ETILDA GJONAJ

E ENJTE 7 KORRIK 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

I nderuar Shkëlqesia e Tij, Ambasador,

Projektrezoluta e sotshme, në nderim dhe përkujtim të viktimave të gjenocidit në Srebrenicë, diskutohet në Kuvend pak ditë përpara 11 korrikut, e shpallur ndërkombëtarisht si Dita e Përkujtimit të Gjenocidit dhe Spastrimit Etnik që ndodhi në zonën e Srebrenicës 27 vjet më parë. Masakra e Srebrenicës duhet të na shërbejë si një kujtesë e formave më të rrezikshme të nacionalizmit dhe intolerancës në shoqëri. Vrasja e 8000 burrave dhe djemve myslimanë, si dhe dëbimi i pothuajse 30 000 grave, fëmijëve dhe të moshuarve nga territori i tyre nga forcat policore boshnjako-serbe është konsideruar si spastrimi masiv etnik më i rëndë që pas fundit të Luftës së Dytë Botërore.

Kuvendi, nëpërmjet kësaj rezolute që diskutohet sot, në përkujtim të gjenocidit të Srebrenicës, tregon jo vetëm rolin e tij në kohezionin që luan për sa i përket politikës së jashtme, por, veçanërisht, asaj në rajon, ashtu siç na rikujton dhe thekson rëndësinë e vlerave të demokracisë dhe bashkëjetesës së mirë midis vendeve fqinjë. Vlera e demokracisë dhe të drejtave të njeriut bëhen më të çmuara dhe nuk merren të mirëqena, sidomos kur ato shkelen apo cenohen. Disa muaj më parë në luftën në Ukrainë na u rikujtuan edhe njëherë vlera e parimeve të demokracisë, për të cilat është luftuar dhe sakrifikuar aq fort, respektimi i të drejtave të njeriut, si dhe garantimi i sigurisë dhe paqes.

Pavarësisht njohjes dhe dënimit të gjenocidit dhe spastrimit etnik nga organizmat ndërkombëtare, nevojitet edhe njohja e ngjarjeve makabre të Srebrenicës nga përfaqësuesit politikë në Bosnje-Hercegovinë, me qëllim që të lihet pas e shkuara dhe të punohet për një të

ardhme më të mirë të njerëzve për të rivendosur ekuilibrat e shoqërisë dhe ngjarje të tilla të mos përsëriten më. Ashtu siç bëhet thirrje edhe në rezolutën e Kuvendit, kjo i shërben bashkëjetesës dhe bashkëpunimit më të mirë me vendet e rajonit, bashkëpunimit të ndërtuar mbi bazën e vlerave të fqinjësisë së mirë, respektit reciprok, parimeve të barazisë dhe forcimit të lidhjeve tona mbi bazën e çdo bashkëpunimi rajonal për paqen, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik.

Njohja e masakrës së Srebrenicës dhe nderimi i të gjithë atyre që kanë vuajtur nga ky gjenocid ndihmon në avancimin bashkërisht të perspektivës së qartë europiane për të gjitha vendet e Ballkanit si prioriteti kryesor qeverisës për politikën e jashtme. Duhet të konsiderohet përgjegjësi dhe detyrë e vendeve të Bashkimit Europian që me strukturat e tyre të angazhohen për anëtarësimin sa më shpejt të gjashtë vendeve të rajonit të Ballkanit. Aspiratat për në BE, siguria dhe përbashkimi në politikën e jashtme, duke përfshirë edhe propozimin e ri për kuadrin politik të presidentit francez, Makron, do ta bëjnë rajonin të realizojë aspiratën e tij europiane. E theksuar në këtë draftrezolutë si një shqetësim i të gjithë komunitetit ndërkombëtar dhe organizatave të të drejtave të njeriut, gjuha e urrejtjes, evidente edhe vitet e fundit, ku glorifikimi dhe mohimi i gjenocidit të Srebrenicës, si dhe mosmarrja e masave nga autoritetet, duhet të gjejnë adresimin edhe në organizmat ndërkombëtarë si shkelje thelbësore e të drejtave të njeriut.

Mosdënimi dhe mohimi i gjenocidit në Srebrenicë është i papajtueshëm me vlerat e parimet europiane. Kuvendi u bashkëngjitet të gjitha qëndrimeve të mbajtura nga organizmat ndërkombëtarë lidhur me dënimin e mosndjekjes penalisht të asnjë rasti nga autoritetet vendase të drejtësisë, në një kohë që masakra dhe rastet individuale janë dokumentuar përtej vështirësisë së venitjes së ngjarjeve me kalimin e kohës, por jo të fakteve. Nisur edhe nga angazhim intensiv i Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, nëpërmjet kësaj rezolute Kuvendi u bën thirrje OKB-së dhe organizatave ndërkombëtare për të rritur angazhimin dhe përpjekjet e tyre serioze për ndjekjen penale dhe ndëshkimin e kriminelëve të luftës dhe bashkëpunëtorëve të tjerë, si një detyrim që kanë jo vetëm ndaj të mbijetuarve të kësaj masakre, por edhe ndaj vlerave të shoqërisë të ndërtuara mbi bazën e drejtësisë.

Bosnjë- Hercegovina ka bërë një rrugë të gjatë në rivendosjen e besimit për këtë ngjarje, por rruga përpara duhet të përfshijë njohjen e vuajtjeve dhe respektin reciprok si një sinjal i fuqishëm në respekt të dinjitetit njerëzor dhe vlerave universale të shoqërisë. Kjo është vendimtare jo vetëm për ta, por edhe për ne dhe shoqërinë, që duam t'ua lëmë trashëgim fëmijëve tanë në respekt të frymës së diversitetit, tolerancës dhe bashkëjetesës midis kulturave të ndryshme. Kjo është deklaruar, gjithashtu, edhe nga komisionerja e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Europës, zonja Dunja Mijatovic, në 23-vjetorin e përkujtimit të masakrës së Srebrenicës.

Për këtë arsye, të dashur kolegë, jam e bindur se biem të gjithë dakord për mesazhet dhe theksin që jep kjo rezolutë dhe e dimë jo vetëm ne që jemi në këtë sallë, por të gjithë shqiptarët, që krime të tilla janë përjetuar edhe në luftën e Kosovës. Faleminderit!